



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL

Bilisht më / /2022

Njoftim për pozicion të lirë Pune
Bashkia Devoll

Mbi bazen e vendimit të Kryetarit të Bashkise Nr.78 date 14/10/2022 me nr. 53 date 15.07.2022 të Keshillit të Bashkise Devoll, miratuar nga Prefekti I Qarkut Korce me Nr 697/1 Prot. date 19.07.2022 protokolluar me tonen me Nr 2512 Prot. date 22.07.2022 njoftojme për vende të lira pune.

Pozicioni:Psikolog

Data e hapjes së aplikimit:18/10/2022

Data e mbylljes së aplikimit: 21/10/2022

Titulli i pozicionit: Psikolog

Vendi: Bashkia Devoll

Kohëzgjatja: 9 muaj

Informacion i përgjithshëm për projektin

Projekti “4 Rrota në Shërbim” është një projekt 12 mujor i financuar nga Fondi Social, i mbështetur nga CRCA/ECPAT Shqipëri dhe që zbatohet në territorin e Bashkise Devoll. Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është përmirësimin e Shërbimeve Sociale që Bashkia Devoll ofron për të mbrojtur fëmijët nga dhuna, neglizhenca dhe shfrytëzimi përmes funksionimit të Shërbimeve psiko-sociale të lëvizshme.

“4 Rrota në Shërbim” nëpërmjet kombinimit të shërbimeve shoqërore të integruara, dhënies së ndihmës ligjore falas dhe këshillimit psikologjik synon të mbrojë, referojë dhe trajtojë çdo nevojë për shërbime që kanë shtresat me nevojë.

Skuadra e shërbimeve të lëvizshme për mbrojtjen e fëmijeve do të ketë si pjesë të saj të personelit psikolog, punonjës sociale dhe jurist, të cilët do të trajtojnë dhe menaxhojnë rastet e fëmijeve dhe të familjeve të tyre. Objektivi kryesor i këtij projekti është garantimi i respektimit të të drejtave të fëmijëve, për të mbrojtur ata nga të gjitha format e abuzimit dhe shfrytëzimit, duke lehtësuar integrimin e tyre në shoqëri përmes ofrimit të shërbimeve të integruara të kujdesit dhe mbrojtjes shoqërore, në bashkëpunim me Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA/ECPAT Shqipëri).



Funksionet bazë të pozicionit:

Bashkia Devoll kërkon të angazhojë **nje (1): Psikolog**

Për të ofruar shërbime këshillimi dhe mbështetjeje psikologjike për personat me aftësi të kufizuar, femijet në situatë rruge, jetim, me aftësi të kufizuara, si dhe fëmijët viktime të dhunës abuzimit apo shfrytëzimit.

Detyrat e psikologut janë këto:

1. Vlerësimi i funksionimit social. Ky aktivitet realizohet duke:
 - a- Vlerësuar mënyrën sesi pacienti i krijon marrëdhëniet me njerëzit rreth tij, grupet, institucionet dhe komunitetin në të cilin bën pjesë.
 - b- Evidentuar stresorët dhe faktorët socialë që ndikojnë në rëndimin e gjendjes.
 - c- Vlerësuar nevojat sociale qoftë në planin individual, qoftë në atë familjar.
 - d- Ekzaminuar burimet mbështetëse dhe pikat e forta të pacientit që do të lehtësonin punën e stafit.
2. Këshillimi emocional. Ai fokusohet kryesisht në:
 - a- teknikat mbështetëse me qëllim zbutjen dhe lehtësimin e ngarkesës emocionale. Realizon seanca këshillimi individuale apo në grup, në Qendër ose në komunitet.
 - b- ndërhyrje në rastet e krizave duke u bazuar në këshillim intensiv.
3. Puna me familjen.
 - a- vlerësimin e dinamikave të familjes, roleve të anëtarëve, mënyrave të ndërveprimit dhe komunikimit mes pjesëtarëve të familjes etj.
 - b- psikoedukim, në mënyrë që familjarët të kuptojnë sëmundjen dhe sesi të reagojnë ndaj saj,
 - c- punë me anëtarët e familjes për të ulur ndjenjat e fajësisë, konsumimit etj.
4. Të qënit anëtar aktiv në ekipin multidisiplinar, duke bashkëpunuar ngushtë me profesionistët e tjerë
5. Ofron trajtim psikologjik individual: Psikologu punon me individin me qëllim lehtësimin e shqetësimit dhe ruajtjen e funksionimit. Gjithashtu ndihmon në rritjen e aftësive dhe pavarësinë e pacientit. Ai / ajo e realizon këtë nëpërmjet:
 - a- Psikoterapisë individuale
 - b- Këshillimit psikologjik
 - c- Mbështetjes emocionale
 - d- Trajnimit të shprehive (shprehi emocionale, konjitive, sociale, praktike etj)

Informacion për pozicionin e punës:

Shërbimi nga psikologu do të kryhet me 50% të kohës



Psikologu do të shoqërohet gjithmonë nga Stafi i Sektorit të Kujdesit Social, bazuar në bashkëpunimin e CRCA/ECPAT dhe Bashkisë Devoll.

Kualifikimet e kërkuara:

Kandidati/ja duhet të përmbushë këto kritere:

- Të jetë i/e diplomuar në Psikologji;
- Të zotërojë licensën e Psikologut;
- Të ketë të paktën 3 vjet punë dhe eksperience në këshillim ose shërbime komunitare;
- Të mos jetë akuzuar apo dënuar më parë për vepra penale;
- Të jetë i/e rekomanduar nga dy punëdhënës, të cilët i njohin aftësitë profesionale dhe personale të kandidatit/es;

Për të aplikuar:

Kandidatët e interesuar ftohen të dorëzojnë dokumentet vijuese për aplikim jo më vonë se data **21/10/2022** në adresën: bashkiadevoll@gmail.com .

- CV-në që tregon sfondin e arsimimit dhe përvojës, dhe një listë të detyrave të ngjashme të përfunduara

- Letër Shprehje interesi (një faqe) për këtë pozicion.

Të tjera:

- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave.

- Fotokopje të librezës së punës;

- Fotokopje të kartës së identitetit;

- Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

- Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;

- Certifikata të kualifikimeve;

- Referenca pune.

Spektori i Burimeve Njerezore